



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M
Nr. 68, datë 30.10.2017

**PËR MIRATIMIN SI PRIORITET TË INVESTIMIT ME OBJEKT:
RIKONSTRUKSION I KATIT TË DYTË TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “EDITH
DURHAM” DHE DELEGIMIN E KËTIJ FUNKSIONI KËSHILLIT TË QARKUT
SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.10.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë dhe me propozimet e këshilltarëve, mbështetur në nenin 9 pika 1.2 shkronja “c”, pika 1.5, nenin 14, nenin 23 pika 11, nenin 31 pika 2, nenin 54 shkronja “dh”, nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, te ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, shkresën nr. 624/1 prot, datë 8.6.2017 të Prefektit të Qarkut Shkodër,

V E N D O S I :

1. Të miratojë si prioritet investimin me objekt : “Rikonstruksion i katit të dytë të shkollës 9-vjeçare “Edith Durham”.
2. Delegimin e ekzekutimit të këtij funksioni për objektin e mësipërm, Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë për lidhjen e Marrëveshjes me Këshillin e Qarkut Shkodër, për këtë qëllim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.10.2017

Shpallur në datën 3.11.2017

Sekretar i këshillit

Suel Hadri

KRYETAR

Xhemal BUSHATI

